FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 171	**29 tetor**	**2013**

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i GJL nr. 6, datë 1.6.2011	Me objekt: Të njihet dhe t'i jepet fuqi vendimit të datës 22.12.2005 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.), që i përket çështjes nr. 12112/ACS, të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof. dr. Claudie B. Rouillier……	7501

VENDIM
Nr. 6, datë 1.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	kryesuese
Ardian Dvorani	anëtar
Gani Dizdari	anëtar
Besnik Imeraj	anëtar
Fatos Lulo	anëtar
Ardian Nuni	anëtar
Majlinda Andrea	anëtare
Arjana Fullani	anëtare
Aleksandër Muskaj	anëtar
Evelina Qirjako	anëtare
Guxim Zenelaj	anëtar
Andi Çeliku	anëtar
Mirela Fana	anëtare
Medi Bici	anëtar

në seancën gjyqësore të datës 1.6.2011, morën në shqyrtim çështjen civile që u përket palëve:

KËRKUES: 1. "I.C.M.A. s.r.l" shoqëri në likuidim, e krijuar sipas ligjit italian, me qendër në "Via Roma Nord n. 155, Vila Poma (MN) Itali", në mungesë;

2. "AGRI. BEN S.A.S", shoqëri e së drejtës italiane, me qendër në "Via Roma Nord n. 161/1, Vila Poma (MN) Itali", në mungesë.

PERSONI I TRETË: Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, në mungesë.

OBJEKTI: Të njihet dhe t'i jepet fuqi vendimit të datës 22.12.2005 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.), që i përket çështjes nr. 12112/ACS, të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof. dr. Claudie B. Rouillier.

BAZA LIGJORE: Nenet 393, 395 dhe 399 të Kodit të Procedurës Civile

----

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 82, datë 7.9.2007, ka vendosur:

"Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj."

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, kanë ushtruar rekurs palët kërkuese *"I.C.M.A. s.r.l në likuidim"* dhe "*AGRI.BEN s.a.s.",* të cilat kërkojnë prishjen e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës, duke parashtruar këto shkaqe:

- Gjykata e apelit pa të drejtë ka rrëzuar kërkesën. Ajo është e mbështetur në nenin 393 dhe 395 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në ligjin nr. 8688, datë 9.11.2000 *"Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën për Njohjen e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit Ndërkombëtar"*.

- Në zbatim të nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile, vendimin e huaj e kemi paraqitur para kësaj gjykate në origjinal dhe të përkthyer në gjuhën shqipe. Po kështu, të gjitha dokumentet janë të legalizuara sipas kërkesave të ligjit për legalizimin e dokumenteve të huaja.

- Vendimi i paraqitur për njohje është në përputhje edhe me parimet bazë të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka asnjë pengesë ligjore nga ato që parashikon neni 394 i Kodit të Procedurës Civile.

- Gjykata e apelit ka arsyetuar se çështja nuk është në kompetencën e arbitrazhit ndërkombëtar, në një kohë kur të dyja palët e kanë zgjedhur vetë organin kompetent për zgjidhjen e konfliktit në rastin e mundshëm. Pra, Gjykata e Apelit Tiranë, padrejtësisht ka hyrë në vlerësimin e kompetencës, pasi ky problem është trajtuar dhe zgjidhur nga ajo gjykatë që ka shqyrtuar çështjen në themel.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 26.6.2009, ka vendosur:

"Kalimin e çështjes për gjykim Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njehsimin e praktikës gjyqësore".

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Ardian Nuni, si dhe e diskutuan çështjen në tërësi,

VËREJNË:

1. Vendimi nr. 82, datë 7.9.2007 i Gjykatës së Apelit Tiranë është dhënë në zbatim të gabuar të ligjit procedural, prandaj duhet të prishet dhe çështja t'i dërgohet për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

2. Gjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e apelit rezultojnë të pranuara si të vërtetuara rrethanat e faktit si më poshtë:

2.1 Palët kërkuese *"I.C.M.A. s.r.l në likuidim"* dhe *"AGRI.BEN" s.a.s*, në cilësinë e dy prej ortakëve të shoqërisë tregtare të së drejtës shqiptare *"Pranvera" sh.p.k.,* duke pretenduar se nga ana e palës së paditur, *Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit*, janë kryer veprime në kundërshtim me ligjin shqiptar, si edhe me detyrimet që buronin nga akti i themelimit dhe statuti i kësaj shoqërie tregtare, me pasojë humbje financiare, mosrealizim të objektivave dhe bllokimin definitiv të veprimtarisë së saj tregtare, i janë drejtuar për zgjidhjen e konfliktit Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.).

2.2 Me vendimin e datës 22.12.2005 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.), që i përket çështjes nr. 12112/ACS, të dhënë nga arbitri i vetëm prof. dr. Claudie B. Rouillies, me qendër në Gjenevë, është detyruar pala e paditur, *Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë*, t'i paguajë palëve paditëse *"I.C.M.A." s.r.l në likuidim*" dhe "*AGRI.BEN" s.a.s*, si kreditorë të përbashkët:

"1. Shumën prej 1.608.001 dollarë amerikanë me një interes prej 4.61% nga data 1 janar 2005. Interesat e maturuara i shtohen shumës në fund të çdo viti.

2. Shoqëria "Pranvera" sh.p.k., me qendër në Sukth, rrethi i Durrësit, Republika e Shqipërisë, shpërbëhet.

3. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë duhet t'i paguajë "I.C.M.A". s.r.l në likuidim dhe "AGRI.BEN" s.a.s, kreditorë të përbashkët, për shpenzimet e tyre ligjore për arbitrazhin, një shumë prej 143.000 dollarë amerikanë, me një interes prej 4.61% nga data 22 dhjetor 2005. Interesat e maturuara i shtohen shumës në fund të çdo viti.

4. Shpenzimet e Arbitrazhit që arrijnë në shumën 106.000 dollarë amerikanë, do të mbulohen nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë. Prandaj urdhërohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit të Republikës së Shqipërisë të rimbursojë "I.C.M.A." s.r.l në likuidim dhe "AGRI.BEN" s.a.s, kreditorë të përbashkët, me shumën prej 106.000 dollarë amerikanë, e cila është paguar nga "I.C.M.A." s.r.l në likuidim".

3. Në të tilla rrethana, palët paditëse gjyqfituese, "*I.C.M.A.*" *s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN*" *s.a.s*, në cilësinë e kërkuesit, i janë drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë me kërkesë për njohjen dhe dhënien fuqi të vendimit të datës 22.12.2005 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.), të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof. dr. Claudie B. Rouillier, që i përket çështjes nr. 12112/ACS.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, në seancë gjyqësore, kryesisht, ka vlerësuar dhe ka thirrur në gjykim, në cilësinë e personit të tretë, palën gjyqbjerrëse *Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit*.

5. Me këtë ndërgjyqësi, pasi e ka shqyrtuar çështjen, Gjykata e Apelit Tiranë ka dhënë vendimin nr. 82, datë 7.9.2007, me të cilin ka vendosur rrëzimin e kërkesës së palëve kërkuese "*I.C.M.A.*" *s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN*" *s.a.s*, për njohjen e dhënien fuqi të vendimit të datës 22.12.2005 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.), me arbitër të vetëm prof. dr. Claudie Rouillier, që i përket çështjes nr. 12112/ACS.

6. Në mënyrë të përmbledhur, arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë përmban këto argumente dhe qëndrime:

6.1 *Së pari*, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosje ka rezultuar se, në kundërshtim me nenin 65 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, pala kërkuese nuk rezulton të ketë paguar 1% të vlerës së vendimit të arbitrazhit që kërkohet të njihet dhe jepet fuqi nga gjykata e apelit.

6.2 *Së dyti*, ortakë të shoqërisë *"Pranvera" sh.p.k.* janë N. B. Sukth dhe OSV Sri. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Republikës së Shqipërisë nuk është ortake në këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe as mund të jetë, për shkak se ndalohet nga ligji. Kjo Ministri është një organ i administratës qendrore që ka për objekt të veprimtarisë së saj bashkërendimin apo administrimin e politikave qeveritare në fushën e bujqësisë dhe ushqimit dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret me veprimtari tregtare apo biznesi.

6.3 *Së treti*, ushtrimin e veprimtarisë së natyrës tregtare e ka pasur për objekt shoqëria *"Pranvera" sh.p.k.* Kjo shoqëri tregtare, siç theksohet edhe në kërkesë, është një shoqëri në likuidim e sipër. Likuidimi i shoqërive bëhet sipas dispozitave të seksionit V "*Likuidimi*" të ligjit nr. 7638, datë 9.11.1992 "*Për shoqëritë tregtare*". Në nenin 281 të këtij ligji, parashikohet se kur ortakët kanë mosmarrëveshje, likuidatori dhe procedurat e tjera caktohen dhe zgjidhen me urdhër të gjykatës. Kërkuesi, ndonëse pretendon, nuk ka paraqitur asnjë akt që të provojë se shoqëria *"Pranvera" sh.p.k.* është në likuidim dhe i është caktuar likuidatori.

7. Gjykata e Apelit Tiranë, në përfundim të arsyetimit të saj, ka konkluduar se ekzistojnë kushtet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "dh" të nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile për njohjen e vendimit të huaj, pra ka pengesë ligjore për njohjen dhe dhënien fuqi ligjore të vendimit të mësipërm, për shkak se nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

8. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në mbështetje të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, kanë ushtruar rekurs palët kërkuese "*I.C.M.A." s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN*" *s.a.s.*, të cilat kërkojnë ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës, duke parashtruar shkaqet e treguara në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

9. Duke vlerësuar se në praktikën gjyqësore ka qëndrime të ndryshme deri edhe të kundërta për njohjen e vendimeve civile të dhëna nga gjykatat e huaja lidhur me ndërgjyqësinë, natyrën dhe objektin e këtij lloji të gjykimit të posaçëm etj., Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 26.6.2009, ka disponuar për kalimin e çështjes për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për të njehsuar praktikën gjyqësore.

9.1 Kështu, Kolegji Civil parashtron në arsyetimin e tij se, lidhur me formimin e ndërgjyqësisë, si një element thelbësor i procedimit gjyqësor civil në çështjet me objekt njohjen e vendimeve të huaja, janë mbajtur qëndrime të ndryshme nga gjykatat e apelit. Sipas njërit qëndrim, lejohet një ndërgjyqësi e tillë në të cilën thirret e shqyrtohet çështja vetëm me praninë e palës që kërkon njohjen e vendimit të gjykatës së huaj, sikurse ka çmuar, p.sh., Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 27, datë 5.12.2005 etj. Ndërsa, sipas qëndrimit tjetër, sikurse në çështjen objekt i këtij gjykimi, nëse nuk është treguar në vetë kërkesën për njohjen e vendimit të huaj, është vetë gjykata e apelit, e cila, edhe kryesisht, thërret në gjykim si palë të tretë ato palë që rezultojnë gjyqbjerrëse e të ngarkuara me detyrime debitore nga vendimi i huaj që kërkohet t'i jepet fuqi dhe të ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë.

9.2 Nga shqyrtimi i dispozitave që përmbahen në kreun IX (nenet 393-399) të Kodit të Procedurës Civile vërehet se ato, për sa i përket ndërgjyqësisë, nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur nëse gjykimi në apel do të bëhet me të dyja palët, gjyqfituesin e gjyqbjerrësin, apo vetëm me gjyqfituesin që kërkon ekzekutimin e vendimit të dhënë nga gjykata e huaj.

9.3 Po kështu, ndryshe nga dispozitat e Konventës së Kombeve të Bashkuara *"Për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit"* Nju-Jork, 10 qershor 1958, në të cilën Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr. 8688, datë 9.11.2000 (**Konventa e Nju-Jorkut**), pra pas hyrjes në fuqi të Kodit të Procedurës Civile, vërehet se dispozitat procedurale civile të sipërcituara (nenet 393-399) nuk bëjnë rregullim të shprehur të disa çështjeve të tjera që lidhen me kushtet dhe procedurën e pranueshmërisë për gjykim dhe atyre për shqyrtimin e çështjeve me shkak ligjor dhe objekt njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit.

9.4 Në rrethana të tilla, bazuar në nenet 480 e 481 të Kodit të Procedurës Civile, Kolegji Civil ka çmuar se është vendi për të investuar Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë për njësimin e praktikës gjyqësore, nëpërmjet një vendimi unifikues, me të cilin, duke e zgjidhur drejt çështjen, këto Kolegje t'u japin përgjigje edhe pyetjeve:

- Cili do të konsiderohet formim i drejtë i ndërgjyqësisë në gjykimin e një kërkese për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj sipas neneve 393-397 të Kodit të Procedurës Civile?

- Gjykimi në apel do të bëhet me të dyja palët, gjyqfituesin e gjyqbjerrësin, apo vetëm me gjyqfituesin që kërkon ekzekutimin e vendimit të dhënë nga gjykata e huaj?

- Nëse në këtë gjykim do të zbatohen rregullat për pranimin për shqyrtim të kërkesës, të njëjta me ato të kërkesëpadisë sikurse janë pagesa e taksës prej 1% të vlerës së padisë etj.?

Vlerësimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë

10. Nisur nga rrethanat e faktit, ashtu sikurse i ka pranuar gjykata e apelit në vendimin e saj, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vërejnë se çështja objekt i këtij gjykimi lidhet me njohjen dhe dhënien fuqi, me qëllimin që të zbatohet dhe ekzekutohet në Republikën e Shqipërisë, të një vendimi të dhënë nga një gjykatë e huaj nga Gjykata Ndërkombëtare e Arbitrazhit (I.C.C.).

11. Për sa i përket ligjit të zbatueshëm lidhur me procedurat që duhet të zbatohen për njohjen e vendimeve gjyqësore dhe atyre të arbitrazheve të huaja, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, si në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes, ashtu edhe të njehsimit të praktikës gjyqësore, është vendi që të interpretohen dhe zbatohen drejt, para së gjithash, dispozita e nenit 122 të Kushtetutës, dispozitat e neneve 393-399 të Kodit të Procedurës Civile, si edhe dispozitat e neneve 2, 3, 4 dhe 5 të Konventës së Nju-Jorkut.

12. Kështu, në Kodin e Procedurës Civile, neni 393 parashikon mundësinë që vendimet e gjykatave të huaja të njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, por gjithmonë e në çdo rast, në respektim të kushteve të parashikuara nga ligji dhe marrëveshja ndërkombëtare:

"Neni 393

Vendimet e gjykatave të shteteve të huaja njihen dhe zbatohen në Republikën e Shqipërisë, në kushtet e parashikuara në këtë Kod ose në ligje të veçanta.

Kur për këtë qëllim ka marrëveshje të posaçme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe shtetit të huaj zbatohen dispozitat e marrëveshjes".

13. Gjithashtu, neni 399 qartësisht parashikon se, në parim, edhe vendimet e gjykatave të huaja të arbitrazhit, pra si të atyre ndërkombëtare, ashtu edhe të shteteve të tjera, do të njihen dhe ekzekutohen sipas së njëjtës procedurë dhe të njëjtave kushte sikurse edhe vendimet e gjykatave të huaja:

"Neni 399

Dispozitat e këtij kreu zbatohen edhe për njohjen e vendimit përfundimtar të një arbitrazhi të shtetit të huaj".

14. Kodi i Procedurës Civile, në dispozitën e paragrafit të parë të nenit 395, parashikon se kompetenca lëndore për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja u përket gjykatave të apelit.

15. Ndërsa në nenin 397 të këtij Kodi parashikohet se procedura e njohjes dhe e zbatimit të vendimeve të gjykatave të huaja, pra edhe atyre të gjykatave të huaja të arbitrazhit, ka për objekt vetëm hetimin gjyqësor mbi ekzistencën ose jo të kushteve substanciale penguese a ndaluese të parashikuara shprehimisht nga ligji, konkretisht nga neni 394 i atij Kodi. Pra, gjykimi i kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj nuk ka për objekt themelin e këtij vendimi të huaj:

"Neni 397

Gjykata e apelit nuk e shqyrton çështjen në themel, por vetëm kontrollon nëse vendimi i paraqitur nuk përmban dispozita që vijnë në kundërshtim me nenin 394".

16. Pra, në çështjet gjyqësore me objekt kërkimi dhënien fuqi të vendimeve të gjykatave të huaja dhe të gjykatave të huaja të arbitrazhit, objekti i hetimit gjyqësor është vetëm verifikimi i ekzistencës ose jo të ndonjërës prej pengesave ligjore substanciale që parashikohen nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ndonjë marrëveshje ndërkombëtare ku është palë Republika e Shqipërisë, ose në ndonjë dispozitë tjetër ligjore të posaçme.

17. Në hetimin gjyqësor të çështjeve, në të cilat kërkohet dhënia fuqi vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit, në pajtim me nenin 122 të Kushtetutës, detyrimisht duhet të mbahen parasysh edhe verifikimi i ekzistencës ose jo të ndonjërës prej pengesave ligjore substanciale që përmbahen nga dispozita e nenit 5 të Konventës së Nju-Jorkut, nëse palët ndërgjyqëse u përkasin shteteve që janë palë të kësaj Konvente.

17.1 Gjykata e apelit, në shqyrtimin e kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, mbështetet në parimet dhe kriteret e Konventës së Nju-Jorkut edhe nëse pala kërkuese i përket ligjit të një shteti që nuk është palë në këtë Konventë, me kushtin që Kodi i Procedurës Civile ose ndonjë ligj i posaçëm të mos përmbajë një rregullim të ndryshëm, si edhe të mos rezultojë se janë të zbatueshme, për atë rast, dispozita të tjera të posaçme të parashikuara në një marrëveshje tjetër ndërkombëtare, me fuqi detyruese, si për palën kreditore, ashtu edhe për palën debitore.

17.2 Nga shqyrtimi i përmbajtjes së dispozitës së nenit 5 të Konventës së Nju-Jorkut, rezulton se kushtet substanciale ligjore për efekt të pranimit ose jo të kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, në pjesën më të madhe të tyre, në thelb, janë të njëjta ose kompatibël me ato të parashikuara në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile.

18. Por, nga ana tjetër, si dispozita e nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile, ashtu edhe dispozita e nenit 4 të Konventës së Nju-Jorkut, parashikojnë edhe nevojën e respektimit të disa kushteve formale-procedurale, përmbushja e të cilave duhet të hetohet paraprakisht nga gjykata e apelit, pra përpara se të kalohet në fazën e hetimit gjyqësor për të verifikuar ekzistencën ose jo të pengesave ligjore për njohjen e vendimit të huaj, të cilat parashikohen nga dispozita e nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile ose neni 5 i Konventës së Nju-Jorkut.

18.1 Nëse kërkesa për njohje e zbatim të vendimit të gjykatës së huaj nuk përmbush këto kushte formale dhe ato nuk riparohen (plotësohen) nga pala kërkuese, sipas rregullave procedurale-civile mbi paraqitjen e padisë, atëherë nuk është e nevojshme që gjykata të vijojë më tej shqyrtimin e çështjes lidhur me hetimin mbi ekzistencën ose jo të pengesave ligjore për njohjen e vendimit të huaj të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, pra për të disponuar me vendim përfundimtar për pranimin apo rrëzimin e kërkesës për njohjen e vendimit të huaj.

19. Nisur nga sa parashtrohet më sipër lidhur me normat procedurale-civile të zbatueshme për gjykimin e posaçëm të njohjes së vendimeve të dhëna nga gjykatat e huaja dhe gjykatat e huaja të arbitrazhit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë të evidentojnë se, shqyrtimi e gjykimi nga ana e gjykatës së apelit të kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj, duhet të kalojë në dy faza.

19.1 Në fazën e parë, gjykata e apelit verifikon përmbushjen e kushteve formale-procedurale, pra të rregullshmërisë formale të paraqitjes, për efekt të pranimit për shqyrtim të kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj. Këto kushte e rregulla janë parashikuar shprehimisht nga nenet 395 dhe 396 të Kodit të Procedurës Civile. Lidhur me vendimet e gjykatës së huaj të arbitrazhit, gjykata detyrimisht mban parasysh edhe kushtet e rregullat më të posaçme të parashikuara në nenin 4 të Konventës së Nju-Jorkut, apo në marrëveshje të tjera ndërkombëtare, posaçërisht të zbatueshme për atë rast në gjykim.

19.2 Kështu, në nenet 395 dhe 396 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se:

"Neni 395

Kërkesa për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj i paraqitet gjykatës së apelit. Kërkesa mund të paraqitet edhe në rrugë diplomatike kur ajo është e lejueshme nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe mbi bazën e reciprocitetit.

Në këto raste, në qoftë se pala e interesuar nuk ka emëruar përfaqësues, kryetari i gjykatës së apelit emëron një avokat për të paraqitur kërkesën.

Neni 396

Kërkesës për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj duhet t'i bashkëngjiten:

a) kopja e vendimit që duhet të zbatohet dhe përkthimi i tij në gjuhën shqipe i legalizuar nga noteri;

b) vërtetim nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimi e legalizimi noterial i tij. Si kopja e vendimit, ashtu edhe vërtetimi se vendimi ka marrë formë të prerë, duhet të jenë vërtetuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë;

c) prokura, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, e përkthyer dhe e legalizuar te noteri.

19.3 Ndërsa në nenin 4 të Konventës së Nju-Jorkut, parashikohet se:

"Neni 4

1. Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit siç përmendet në nenin e mësipërm, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën, sa vijon:

a) origjinalin e vendimit të arbitrazhit, të vërtetuar rregullisht ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur;

b) origjinalin e marrëveshjes me shkrim të parashikuar në nenin 2 ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur.

2. Në qoftë se vendimi ose marrëveshja në fjalë nuk është hartuar në një gjuhë zyrtare të vendit ku jepet vendimi, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit duhet të paraqesë një përkthim të këtyre dokumenteve në ato gjuhë. Përkthimi duhet vërtetuar nga një përkthyes zyrtar ose një përkthyes i betuar, ose nga një agjent diplomatik apo konsullor".

19.4 Duke qenë se zhvillon një gjykim të natyrës fillestare, sikurse çdo gjykatë e shkallës së parë, gjykata e apelit zbaton rregullat procedurale për verifikimin e rregullshmërisë formale të paraqitjes së kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj. Nëse ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin e tyre, në të kundërt i kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim të mëtejshëm.

19.5 Këto verifikime, gjykata e apelit i realizon me paraqitjen e kërkesës ose në kuadër të veprimeve përgatitore, kryesisht apo me kërkesën e palëve.

19.6 Pra, në këtë fazë të procesit, sikurse veprohet edhe me kërkesëpaditë e tjera në gjykatat e shkallës së parë, gjykata e apelit nuk mund të rrëzojë kërkesën me motivin se ka të meta e mangësi, sepse nuk janë plotësuar kushtet formale për pranueshmërinë për gjykim "në themel" të saj. Pranimi apo rrëzimi i kërkesës për njohjen e vendimit gjyqësor të huaj bëhet në fazën e dytë të gjykimit, vetëm në varësi të vërtetimit ose jo të ekzistencës së ndonjërës prej pengesave e ndalimeve ligjore substanciale që ka parashikuar ligji për njohjen e atij vendimi.

20. Në fazën e dytë, pra nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore në të cilën objekti i gjykimit është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej pengesave dhe ndalimeve ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventës së Nju-Jorkut apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshje tjetër ndërkombëtare.

20.1 Pasi ka dëgjuar argumentet dhe prapësimet përkatëse të palëve ndërgjyqëse, në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së huaj të arbitrazhit.

21. Për sa i përket ndërgjyqësisë, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se dispozitat e Kodit të Procedurës Civile nuk përmbajnë ndonjë rregullim të shprehur. Megjithatë, gjykata e apelit duhet të mbajë parasysh se edhe në këtë lloj gjykimi duhet të garantohet kontradiktorialiteti për aq sa janë vetë qëllimi, objekti e kufijtë e këtij gjykimi. Kjo realizohet, pikësëpari, nëpërmjet garantimit të së drejtës për

të marrë pjesë e për t'u dëgjuar nga gjykata, si të palës që kërkon njohjen dhe ekzekutimin e vendimit të gjykatës së huaj, ashtu edhe të palëve debitore që ngarkohen me detyrime nga ai vendim i huaj.

21.1 Por, ndryshe nga Kodi i Procedurës Civile, për sa i përket njohjes së vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit, në dispozitat e Konventës së Nju-Jorkut parashikohen shprehimisht rregulla detyruese, të cilat përcaktojnë formimin e drejtë të ndërgjyqësisë. Sipas këtyre dispozitave rezulton qartë se, në këtë gjykim, duhet të thirret jo vetëm pala kreditore kërkuese, por edhe palët debitore të ngarkuara me detyrime nga vendimi i gjykatës së huaj të arbitrazhit.

22. Sipas nenit 396 të Kodit të Procedurës Civile, pala kreditore që kërkon dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ka vetëm detyrimin që t'i paraqesë gjykatës kopjen e vendimit që duhet të zbatohet, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuar nga noteri, vërtetimin nga gjykata që e ka nxjerrë vendimin se ai ka marrë formë të prerë, si edhe përkthimin e legalizimin noterial të tij. Të dy këto akte me shkresë duhet të paraqiten të vërtetuara nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Shqipërisë. Së fundi, pala kërkuese ka edhe detyrimin të paraqesë në gjykatën e apelit prokurën, në rast se kërkesa paraqitet nga përfaqësuesi i të interesuarit, edhe kjo e përkthyer dhe e legalizuar nga noteri.

22.1 Edhe Konventa e Nju-Jorkut, në nenin 4 të saj (të cituar më sipër në pikën 19.3 të këtij vendimi unifikues), për sa u përket akteve që duhet t'i bashkëlidhen kërkesës për njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit, parashikon rregulla e kushte të ngjashme me ato të nenit 396 të Kodit Procedurës Civile. Por dispozita e nenit 4 të Konventës në shkronjën "b" të pikës 1 të tij, përmban edhe një kusht të posaçëm dhe të rëndësishëm, sipas të cilit pala kërkuese ka detyrimin që të paraqesë bashkëlidhur kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së arbitrazhit të huaj edhe origjinalin apo kopjen e vërtetuar rregullisht të marrëveshjes me shkrim për arbitrazh të lidhur mes palëve ndërgjyqëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në gjykim.

23. Sikurse parashtrohet më sipër në pikat 19 deri 19.5 të këtij vendimi unifikues, qysh me paraqitjen e kërkesës apo nëpërmjet veprimeve përgatitore, gjykata e apelit, edhe kryesisht, pra edhe pa thirrjen, praninë apo dëgjimin e qëndrimit të palës debitore, është në gjendje, madje ka detyrimin ligjor që të verifikojë nëse kërkesa për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj është e plotësuar, duke përmbajtur bashkëlidhur aktet që tregohen shprehimisht në nenin 396 të Kodit të Procedurës Civile.

23.1 Në rastin e njohjes së vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, nëse nuk ka marrëveshje tjetër ndërkombëtare që parashikon ndryshe, kërkesa drejtuar gjykatës shqiptare të apelit duhet të plotësojë edhe të gjitha kushtet që përmbahen në nenin 4 të Konventës së Nju-Jorkut. Edhe pse shteti i palës kërkuese mund të mos jetë palë në këtë Konventë, gjykata e apelit, nga ana e saj, në mungesë të rregullimeve të tjera normative të posaçme, duhet t'u përmbahet standardeve dhe kritereve të vendosura nga kjo Konventë.

24. Kolegjet e Bashkuara vërejnë se arsyetimet dhe përfundimet e mësipërme gjejnë plotësisht mbështetje në dispozitën e nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile. Nga vetë përmbajtja, kuptimi dhe qëllimi i pengesave ligjore të parashikuara nga kjo dispozitë, qartazi rezulton se, thjesht vetëm nëpërmjet shqyrtimit të akteve të treguara në nenin 396 të këtij Kodi, me ndonjë përjashtim (si p.sh., shkronja "dh" e nenit 394), gjykata e apelit e ka thuajse të pamundur që, edhe kryesisht, të verifikojë nëse ndodhet përpara ndonjërës prej pengesave ligjore për njohjen e vendimit të huaj sipas nenit 394. Nga ana tjetër, është vendi për të evidentuar edhe se, pala kërkuese, jo vetëm që nuk ka detyrim ligjor, por as edhe nuk ka ndonjë interes fillestar të paraqesë prova dhe argumente në lidhje me këto çështje.

24.1 Është pala debitore ajo që, eventualisht, është e interesuar për të evidentuar se ekziston ndonjë ndalim a pengesë ligjore sipas nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile, të tilla që mund të motivojnë gjykatën e apelit të mos pranojë kërkesën për njohjen e vendimit të huaj. Qoftë edhe për shkak të pjesëmarrjes e ndjekjes së procesit në gjykimin e zhvilluar nga gjykata e huaj, e cila ka dhënë vendimin që kërkohet t'i jepet fuqi nga gjykata shqiptare e apelit, është pala debitore ajo që ka interes dhe eventualisht dijeni për ecurinë e tij, apo që ka dijeni e ka marrë pjesë në gjykime të tjera, tashmë të përfunduara ose në gjykime të tjera ende në shqyrtim nga gjykata të tjera të juridiksionit shqiptar a të huaj.

25. Ndërkohë që, lidhur me njohjen e vendimeve të gjykatave të huaja të arbitrazhit, krahas interpretimit dhe zbatimit të drejtë të dispozitave të sipërcituara të Kodit të Procedurës Civile, nëse nuk

ka një marrëveshje tjetër ndërkombëtare me rregullime më të posaçme, është Konventa e Nju-Jorkut që përmban rregulla të qarta normative lidhur me ndërgjyqësinë. Këto rregullime janë në përputhje të plotë dhe, nga ana tjetër, konfirmojnë interpretimin që nga Kolegjet e Bashkuara bëhet më sipër në këtë vendim unifikues për sa i përket ndërtimit të drejtë të ndërgjyqësisë në çështjet me shkak ligjor dhe objekt njohjen e vendimit të huaj.

26. Më konkretisht, Konventa e Nju-Jorkut i ngarkon shprehimisht palës kërkuese kreditore detyrimin dhe barrën e provës për të paraqitur dokumentacionin e domosdoshëm bashkëlidhur kërkesës që i drejtohet gjykatës së shtetit ku kërkohet njohja e vendimit të arbitrazhit të huaj, kur në nenin 4 të saj parashikon se: "*Për të siguruar njohjen dhe ekzekutimin e vendimit siç përmendet në nenin e mësipërm, pala që kërkon njohjen dhe ekzekutimin duhet të paraqesë, në të njëjtën kohë me kërkesën sa vijon:……".*

27. Nga ana tjetër, Konventa e Nju-Jorkut, po në mënyrë të shprehur dhe imperative, në nenin 5 të saj parashikon se është detyrimi i palës debitore, që edhe ka barrën e provës, për të paraqitur para gjykatës provat dhe argumentet mbi ekzistencën e pengesave ligjore bazuar në të cilat gjykata duhet të vendosë rrëzimin e kërkesës për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Në këtë kontekst, në pikën 1 të nenit 5 të kësaj Konvente parashikohet se: *"Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohet me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që:……".*

27.1 Pra, në kuptim dhe zbatim të drejtë të kësaj norme ndërkombëtare, pala debitore ka detyrimin dhe barrën e provës të parashtrojë para gjykatës se në çështjen në gjykim jemi përpara njërit prej rasteve penguese për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Nga ky rregullim normativ, rrjedhimisht, mund të konkludohet se, këtë të drejtë e detyrim të saj, pala debitore mund ta ushtrojë e përmbushë vetëm duke qenë palë në procesin ku shqyrtohet kërkesa e palës kreditore për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj.

28. Gjithashtu, neni 5 i Konventës së Nju-Jorkut, në pikën 1 të tij, shkronjat "a" deri "e", parashikon qartë dhe në mënyrë të dallueshme se për cilat pengesa ligjore, pala debitore ka detyrimin dhe barrën e provës të vërtetojë ekzistencën e tyre. Kështu, në pikën 1 të nenit 5 të Konventës së Nju-Jorkut parashikohet se:

"1. Njohja dhe ekzekutimi i vendimit mund të refuzohen me kërkesën e palës kundër së cilës drejtohet, vetëm në qoftë se ajo palë i paraqet autoritetit kompetent ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi, provën që:

a) palët në marrëveshjen që i referohet nenit 2, në bazë të ligjit të zbatueshëm për to, ishin të paafta për të vepruar, ose marrëveshja në fjalë nuk është e vlefshme sipas ligjit, të cilit i janë nënshtruar palët ose mungon ndonjë përcaktim sipas ligjit të vendit ku është dhënë vendimi; ose

b) palës kundër së cilës jepet vendimi nuk i është dhënë njoftimi i rregullt për caktimin e arbitrit ose të procedurës së arbitrazhit, ose ka qenë e paaftë për të paraqitur rastin e saj; ose

c) vendimi trajton një mosmarrëveshje të paparashikuar në marrëveshjen për arbitrazh ose nuk hyn në klauzolën mbi arbitrazhin, ose përmban vendime për çështjet që kalojnë fushën që i nënshtrohet arbitrazhit; megjithatë në qoftë se vendimet për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit mund të veçohen nga ato që nuk i janë nënshtruar, ajo pjesë e vendimit, e cila përmban vendime për çështje që i nënshtrohen arbitrazhit, mund të njihet dhe të ekzekutohet; ose

d) përbërja e autoritetit të arbitrazhit ose e procedurës së arbitrazhit nuk ishte në përputhje me marrëveshjen e palëve; ose

e) vendimi ende nuk është bërë i detyrueshëm për palët, ose është anuluar ose pezulluar nga autoriteti kompetent i shtetit në të cilin, ose sipas ligjit të të cilit, është dhënë ai vendim".

28.1 Kolegjet e Bashkuara vërejnë se, bazuar në nenin 122 të Kushtetutës, duke qenë një marrëveshje ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë, dispozitat e Konventës së Nju-Jorkut prevalojnë kundrejt rregullimeve që përmban Kodi i Procedurës Civile dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme nga gjykatat e apelit që shqyrtojnë kërkesa me objekt njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit.

28.2 Nga ana tjetër, në tërësinë e tyre, pengesat ligjore të parashikuara nga neni 5 i Konventës së Nju-Jorkut, përgjithësisht përkojnë në qëllim apo përmbajtje me parashikimet e shkronjat "b", "c" dhe "ç" të dispozitës së nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile:

"Vendimit të një gjykate të shtetit të huaj nuk i jepet fuqi në Republikën e Shqipërisë kur:

……

b) kërkesëpadia dhe letërthirrja për në gjyq nuk i është njoftuar të paditurit në mungesë, në mënyrë të rregullt e në kohë, për t'i dhënë atij mundësi që të mbrohet;

c) midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt e për të njëjtin shkak, është dhënë një vendim tjetër i ndryshëm nga gjykata shqiptare;

ç) është duke u shqyrtuar nga gjykata shqiptare një padi që është ngritur përpara se vendimi i gjykatës së shtetit të huaj të ketë marrë formë të prerë;……".

28.3 Prandaj Kolegjet e Bashkuara konkludojnë se, kur kërkohet njohja e vendimit të gjykatës së huaj, veçanërisht në lidhje me këto tri pengesa ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, pala debitore ka edhe detyrimin e barrën e provës që të vërtetojë para gjykatës së apelit ekzistencën e së paku njërit prej këtyre pengesave.

29. Sipas nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit nuk i jep fuqi vendimit të dhënë nga gjykata e huaj edhe në rastin kur në gjykimin e kërkesës përkatëse vërtetohet se ekziston njëra nga pengesat ligjore të parashikuara në shkronjat "a", "d" dhe "dh" të tij:

"a) sipas dispozitave që janë në fuqi në Republikën e Shqipërisë, mosmarrëveshja nuk mund të jetë në kompetencën e gjykatës së shtetit që ka dhënë vendimin;

……

d) i është dhënë forma e prerë në kundërshtim me legjislacionin e tij;

dh) nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar".

29.1 Në këto tri raste, prova dhe argumente ligjore përkatëse mund të paraqiten nga palët në proces. Gjithsesi, nisur nga natyra e tyre parimore procesuale e juridiksionale, si edhe duke qenë çështje që lidhen vetëm me zbatimin e ligjit, gjykatës së apelit i mbetet detyrimi ligjor që të hetojë e konstatojë, edhe kryesisht, mbi ekzistencën ose jo të këtyre pengesave ligjore.

30. Edhe Konventa e Nju-Jorkut, në pikën 2 të nenit 5 të saj, parashikon në mënyrë të posaçme dy pengesa të tjera ligjore për t'i dhënë fuqi vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, në thelb, me qëllim e natyrë të njëjtë me ato të shkronjave "a", "d" dhe "dh" të nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile. Kështu në pikën 2 të nenit 5 të Konventës parashikohet se:

"2. Njohja dhe ekzekutimi i një vendimi të arbitrazhit <u>mund të refuzohen,</u> gjithashtu, <u>në qoftë se autoriteti kompetent</u> i vendit ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi <u>konstaton se</u>:

a) objekti i mosmarrëveshjes nuk mund të zgjidhet në rrugë arbitrazhi, sipas ligjit të atij vendi; ose

b) njohja ose ekzekutimi i vendimit do të vinte në kundërshtim me rendin publik të këtij vendi."

30.1 Në dallim nga pengesat ligjore të treguara në pikën 1 të nenit 5 të saj, nga vetë formulimi specifik dhe përmbajtja e pikës 2 të sipërcituar, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin se Konventa e Nju-Jorkut nuk e lidh vërtetimin e këtyre dy pengesave ligjore me ndonjë barrë prove për palët ndërgjyqëse. Për vetë rëndësinë dhe natyrën e tyre parimore, ato mund dhe duhet të verifikohen e <u>konstatohen</u> edhe kryesisht nga ana e autoritetit të shtetit ku kërkohet njohja dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, në rastin tonë nga gjykata e apelit ku është paraqitur kërkesa për njohje.

31. Prandaj, nga arsyetimi dhe interpretimi si më sipër i ligjit të zbatueshëm, në funksion të njehsimit të praktikës gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në këto përfundime:

31.1 ***Gjykata e apelit duhet të verifikojë dhe, eventualisht, të kryejë të gjitha veprimet që i parashikon ligji procedural civil, Konventa e Nju-Jorkut, ligji i posaçëm ose marrëveshja tjetër ndërkombëtare e zbatueshme (nëse ka të tillë), për të garantuar, edhe kryesisht, thirrjen në gjykim të të gjitha palëve debitore që rezultojnë nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së huaj ose gjykatës së huaj të arbitrazhit që kërkohet t'i jepet fuqi nga ajo gjykatë e apelit.***

31.2 ***Në shqyrtimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit, gjykata e apelit zbaton rregullat e gjykimit të shkallës së parë.***

31.3 ***Mes të tjerave, sikurse vepron gjykata e shkallës së parë, me paraqitjen e kërkesëpadisë apo edhe nëpërmjet kryerjes së veprimeve përgatitore, gjykata e apelit paraprakisht verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve formale të paraqitjes së kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Posaçërisht, gjykata e apelit verifikon nëse kërkesa, sipas rastit, plotëson kushtet paraprake formale të parashikuara nga neni 395 e 396 i Kodit të Procedurës Civile, neni 4 i Konventës së Nju-Jorkut apo që përmbahen në ligje të tjera të posaçme ose akte të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme për çështjen në gjykim.***

31.4 ***Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin dhe ndreqjen e tyre. Gjykata e apelit kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim, nëse pala kërkuese, brenda afatit që i është caktuar, nuk plotëson dhe ndreq mangësitë dhe të metat formale të kërkesës.***

31.5 ***Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore, në të cilën objekti i gjykimit është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej ndalimeve a pengesave ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventës së Nju-Jorkut apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshjeje ndërkombëtare. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së arbitrazhit të huaj.***

32. Duke pasur parasysh përfundimet e mësipërme të këtij vendimi, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë e vlerësojnë të gabuar qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 82, datë 7.9.2007, ka vendosur të rrëzojë kërkesën e paraqitur nga palët kërkuese *"I.C.M.A." s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN*" *s.a.s.*, si të pabazuar në ligj.

33. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se Gjykata e Apelit Tiranë ka zbatuar drejt ligjin procedural kur ka çmuar dhe disponuar kryesisht për të thirrur si palë të tretë në gjykim Ministrinë e Bujqësisë dhe Ushqimit, duke qenë se ajo është pala debitore që ngarkohet me përmbushjen e detyrimeve përkatëse nga vendimi i datës 22.12.2005 i Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.) të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof. dr. Claudie B. Rouillier, që i përket çështjes nr. 12112/ACS.

34. Sikurse parashtrohet më sipër në këtë vendim unifikues, Gjykata e Apelit Tiranë, në thelb, e mbështet qëndrimin e saj për rrëzimin e kërkesës për njohje të vendimit të arbitrazhit të huaj në tri motive ligjore, të cilat, sipas vlerësimit të Kolegjeve të Bashkuara, janë rrjedhojë e interpretimit dhe e zbatimit të gabuar të ligjit material dhe procedural civil.

35. Si motiv të parë për rrëzimin e kërkesës për dhënie fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, Gjykata e Apelit Tiranë parashtron në vendimin e saj se, pala kërkuese*"I.C.M.A." s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN*" *s.a.s.*, në kundërshtim me nenin 65 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, nuk rezulton të ketë paguar 1% të vlerës së vendimit të arbitrazhit që kërkohet të njihet dhe jepet fuqi nga ajo gjykatë apeli.

35.1 Kolegjet e Bashkuara çmojnë që, ndryshe nga sa gabimisht arsyeton gjykata e apelit, edhe në rast se pranohet si e vërtetuar në gjykim mospërmbushja e detyrimit ligjor të palës kërkuese për pagesën e taksës mbi aktet dhe eventualisht shpenzimeve të tjera të kërkueshme sipas ligjit, përsëri kjo sjellje e rrethanë nuk përbën shkak për rrëzimin, në themel, të kërkesës për njohje të vendimit të dhënë nga gjykata e huaj, sikurse nuk përbën mbështetje ligjore edhe për rrëzimin e çdo kërkesëpadie a kërkese tjetër që i paraqitet për shqyrtim gjykatës së shkallës së parë. Akoma më tej, edhe nëse një shkelje të tillë të ligjit procedural e konstatojnë gjykatat më të larta, as edhe këto të fundit nuk disponojnë, në themel, për rrëzimin e kërkesës apo padisë.

35.2 Në interpretim dhe zbatim të drejtë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, përbën detyrim për gjykatën e investuar si gjykatë e shkallës së parë, që, me paraqitjen e kërkesëpadisë apo gjatë veprimeve përgatitore, të verifikojë rregullshmërinë formale të kërkesëpadisë, nëse ajo përmban të dhënat e treguara në nenin 154 të këtij Kodi, si edhe nëse ka të bashkëlidhur aktet e treguara në nenin 156 të tij apo në dispozita të tjera ligjore ose të marrëveshjeve ndërkombëtare të zbatueshme sipas rastit.

35.3 Nëse kërkesëpadia nuk përmban elementet dhe të dhënat e kërkuara nga neni 154 i Kodit të Procedurës Civile, ose nuk ka bashkëlidhur aktet e kërkuara nga neni 156 i tij dhe nga dispozita të tjera ligjore të posaçme, atëherë gjykata që shqyrton çështjen si shkallë e parë kryen veprimet dhe disponon sipas dispozitave të neneve 154/a dhe 158/a të këtij Kodi. Por, në asnjë rast, ajo gjykatë nuk shprehet për themelin e kërkimit dhe as nuk disponon me vendim përfundimtar për rrëzimin e kërkesës nisur nga ky motiv ligjor, pra për shkak të mosrespektimit nga kërkuesi a paditësi të kushteve ligjore mbi rregullshmërinë formale të paraqitjes së kërkesëpadisë apo të një kërkese tjetër për gjykim.

35.4 Prandaj, në rigjykim, gjykata e apelit duhet të realizojë të gjitha veprimet procedurale që lidhen me plotësimin nga ana e palës kërkuese të kushteve që ligji procedural parashikon për paraqitjen e kërkesëpadisë, përfshirë edhe dokumentin provues për taksën mbi aktet për aq sa kjo është e kërkueshme dhe e zbatueshme, duke mbajtur parasysh edhe veçantitë përkatëse të rastit të paraqitjes së kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit.

36. Nga ana tjetër, kryesisht, Kolegjet e Bashkuara vërejnë se Gjykata e Apelit Tiranë ka pranuar dhe shqyrtuar kërkesën për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, të paraqitur nga pala kërkuese *"I.C.M.A." s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN" s.a.s.,* pa ezauruar verifikimin paraprak të plotësimit të kushteve formale të paraqitjes së kësaj kërkese në gjykatë, sikurse parashikohen jo vetëm në nenet 154, 156, 395 dhe 396 të Kodit të Procedurës Civile, por edhe në nenin 4 të Konventës së Nju-Jorkut, e zbatueshme drejtpërdrejt në çështjen objekt gjykimi.

36.1 Kështu, neni 4 i Konventës së Nju-Jorkut, në shkronjën "b" të pikës 1 të tij, përmban një kusht tjetër për rregullshmërinë formale të paraqitjes së kërkesës për dhënien fuqi të një vendimi të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Sipas kësaj dispozite, në kërkesën drejtuar gjykatës së shtetit ku kërkohet dhënia fuqi e vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit duhet të paraqitet e bashkëlidhur edhe: "*origjinali i marrëveshjes me shkrim të parashikuar në nenin 2, ose një kopje të vërtetuar në mënyrën e duhur".* Neni 2 i Konventës, ku referohet ky kusht paraprak për pranueshmërinë për shqyrtim në themel të kërkesës, parashikon se: *"Termi "marrëveshje e shkruar" do të përfshijë një klauzolë arbitrazhi në një kontratë ose në një marrëveshje arbitrazhi e nënshkruar nga palët, ose që përmbahet në një shkëmbim letrash ose telegramesh".*

36.2 Në Kodin e Procedurës Civile nuk parashikohet shprehimisht një kusht i tillë paraprak për pranueshmërinë për gjykim të kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Por, në zbatim të nenit 122 të Kushtetutës, prevalon e zbatohet drejtpërdrejt rregullimi që përmban marrëveshja ndërkombëtare, pra dispozita e posaçme e shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 4 të sipërcituar të Konventës së Nju-Jorkut.

36.3 Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore, Kolegjet e Bashkuara konstatojnë se kërkesës së paraqitur për gjykim për dhënie fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit nuk i është bashkëlidhur origjinali i marrëveshjes së arbitrazhit, apo kopje e saj e vërtetuar rregullisht. Marrëveshja e arbitrazhit nuk mund të pranohet se ekziston thjesht nisur nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së arbitrazhit që paraqitet për t'i dhënë fuqi në Republikën e Shqipërisë.

36.4 Gjykata e apelit, vërtet nuk shqyrton themelin e vendimit të huaj, por, në çdo rast, ka të drejtën dhe detyrimin imperativ të verifikojë, mes të tjerash, nëse mes palëve kreditore e debitore ka pasur një marrëveshje arbitrazhi me shkrim, e cila, nga njëra anë përbën themelin mbi të cilin gjykata e huaj e arbitrazhit ka ushtruar juridiksionin e saj dhe, nga ana tjetër, sjell mungesën e juridiksionit gjyqësor shqiptar për gjykimin e zgjidhjen në themel të asaj mosmarrëveshjeje. Ky është edhe një kusht thelbësor i parashikuar nga shkronja "a" e nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile dhe nga pikat 1 e 2 të nenit 4 të Konventës së Nju-Jorkut.

36.5 Verifikimin e plotësimit të kërkesës për dhënie fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit duke i bashkëlidhur origjinalin apo kopjen e vërtetuar rregullisht të marrëveshjes me shkrim për arbitrazh, Gjykata e Apelit Tiranë duhet ta kishte përmbushur qysh me paraqitjen e kërkesës për njohje apo në veprimet përgatitore. Gjithsesi, mungesa e këtij akti në dosjen gjyqësore dhe mosplotësimi i kësaj mangësie nga pala kërkuese, në zbatim të drejtë të ligjit procedural, nuk motivon rrëzimin, por, p.sh., kthimin pa veprim të kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit.

37. Për të njëjtat arsye të parashtruara më sipër, në këtë vendim unifikues, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se nuk gjejnë mbështetje në ligj as edhe pretendimet e ngritura në rekurs nga ana e palëve kërkuese *"I.C.M.A." s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN" s.a.s.,* sipas të cilave kërkesa e tyre është e mbështetur në nenin 393 dhe 395 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në Konventën e Nju-Jorkut, se vendimin e huaj që kërkohet të njihet e kanë paraqitur rregullisht në origjinal, të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të legalizuar sipas kërkesave të ligjit për legalizimin e dokumenteve të huaja. Në rekurs parashtrohet edhe se gjykata shqiptare e apelit nuk mund të shqyrtojë çështjen e "kompetencës" (pra të juridiksionit), pasi palët e kanë zgjedhur vetë gjykatën kompetente dhe se këtë çështje e ka trajtuar e zgjidhur në vendimin e saj gjykata e huaj e arbitrazhit, e cila ka shqyrtuar çështjen në themel.

37.1 Sikurse arsyetohet më sipër, në këtë vendim unifikues, në rrethanat kur kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit nuk i është bashkëlidhur edhe marrëveshja me shkrim e arbitrazhit në origjinal apo kopje e saj e vërtetuar rregullisht, sikurse ka parashikuar posaçërisht nga shkronja "b" e pikës 2 të nenit 4 të Konventës së Nju-Jorkut, atëherë nuk është ezauruar njëri nga kushtet paraprake për pranueshmërinë për shqyrtim në themel të kësaj kërkese, pa plotësimin e së cilës nuk mund të vijohet me shqyrtimin e ndalesave a pengesave të tjera ligjore për njohjen e vendimit të huaj në Republikën e Shqipërisë.

37.2 Nëse mes palëve në konflikt nuk ka pasur marrëveshje apo klauzolë të posaçme arbitrazhi me shkrim, atëherë nuk ka as edhe juridiksion të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Është detyrim ligjor parësor i gjykatës së apelit që të verifikojë nëse vetë gjykatat shqiptare, si pjesë e ushtrimit të pushtetit shtetëror dhe të sovranitetit shtetëror shqiptar, kanë ose jo juridiksion gjyqësor për të ushtruar për zgjidhjen e mosmarrëveshjes apo nëse palët e kanë zgjedhur rregullisht juridiksionin e një gjykate ose arbitrazhi të huaj.

37.3 Këtë verifikim gjykata e apelit ka detyrimin ta përmbushë, pavarësisht se si e ka vlerësuar këtë moment juridiksional vetë gjykata e huaj e arbitrazhit, vendimi i së cilës kërkohet t'i jepet fuqi nga gjykata shqiptare e apelit. Çdo shtet është sovran dhe mund të heqë dorë nga juridiksioni gjyqësor i tij vetëm nëse marrëveshja mes palëve për t'iu drejtuar juridiksionit të huaj është përpiluar me shkrim, është hartuar rregullisht sipas ligjit, nuk është marrëveshje e ndaluar nga legjislacioni i vetë atij shteti. Po kështu, nuk pranohet kërkesa për njohje edhe kur gjykatës së apelit i rezulton se marrëveshja për arbitrazh nuk ka caktuar si kompetente për shqyrtimin e konfliktit atë gjykatë të huaj arbitrazhi, vendimi i së cilës kërkohet të njihet nga ajo gjykatë e apelit.

38. Në të tilla rrethana, Kolegjet e Bashkuara konkludojnë që, në rigjykim, gjykata e apelit të realizojë veprimet përkatëse procedurale për t'u mundësuar palëve kërkuese *"I.C.M.A." s.r.l në likuidim* dhe "*AGRI.BEN" s.a.s*. plotësimin e kërkesës edhe me këtë akt, nëse ai ekziston, duke e paraqitur atë rregullisht e në afatin që do t'i caktohet nga gjykata e apelit.

39. Si motiv të dytë për rrëzimin e kërkesës për dhënie fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, Gjykata e Apelit Tiranë parashtron në vendimin e saj, se ortakë të shoqërisë *"Pranvera" sh.p.k.* janë N. B. Sukth dhe OSV Sri. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit e Republikës së Shqipërisë, e cila është pala e ngarkuar me detyrime sipas vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, të cilit kërkohet t'i jepet fuqi në këtë gjykim, nuk është ortake me shoqërinë *"Pranvera" sh.p.k.* dhe as mund të jetë, për shkak se i ndalohet nga ligji të merret me veprimtari tregtare apo biznesi.

40. Ndërsa si motiv të tretë për rrëzimin e kësaj kërkese, gjykata e apelit parashtron se shoqëria *"Pranvera" sh.p.k.* është një shoqëri në likuidim e sipër. Likuidimi i shoqërive bëhet sipas ligjit nr. 7638, datë 9.11.1992 "*Për shoqëritë tregtare*". Në nenin 281 të këtij ligji parashikohet se kur ortakët kanë mosmarrëveshje, likuidatori dhe procedurat e tjera caktohen dhe zgjidhen me urdhër të gjykatës. Kërkuesi, ndonëse pretendon, nuk ka paraqitur asnjë akt që të provojë se shoqëria është në likuidim dhe është caktuar likuidatori.

41. Gjykata e Apelit Tiranë, ndonëse është e paqartë se cilit motiv të arsyetimit të saj i referohet, ka konkluduar se ekzistojnë pengesat ligjore të parashikuara në shkronjat "a" dhe "dh" të nenit 394 të Kodit të Procedurës Civile për njohjen e dhënien fuqi ligjore të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, pasi nuk pajtohet me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

42. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga shqyrtimi i akteve dhe provave shkresore që përmban dosja gjyqësore, konstatojnë se këto përfundime të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk mbështeten në ndonjë provë shkresore të paraqitur nga palët, të debatuar dhe administruar prej saj në gjykim.

43. Si pala kërkuese, ashtu edhe pala e tretë debitore, sipas barrës përkatëse të provës që u ngarkohet nga ligji, nuk kanë paraqitur ndonjë provë shkresore, sikurse janë akti i themelimit, statuti i shoqërisë "*Pranvera*" *sh.p.k.* apo ndonjë dokument tjetër, që mbështet përfundimin e gjykatës së apelit se pala e tretë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit nuk është ortake e shoqërisë, se shoqëria "*Pranvera*" *sh.p.k.* është shoqëri në likuidim para apo gjatë kohës së arbitrimit etj. Mungesa e marrëveshjes për arbitrazh, bashkëlidhur kërkesës për njohje të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, jo vetëm që nuk lejon gjykatën të shprehet për ekzistencën e juridiksionit të arbitrazhit të huaj, por as edhe nuk mundëson, veç të tjerave, për të konkluduar drejt nëse pala e tretë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit është apo jo palë e asaj marrëveshjeje për arbitrazh apo subjekti që duhet t'i nënshtrohet gjykimit në arbitrazh, rrjedhimit, të ngarkohet me detyrime nga gjykata e huaj e arbitrazhit.

44. Prandaj, në rigjykim, nëse plotësohen nga pala kërkuese kushtet mbi pranueshmërinë për gjykim të kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj të arbitrazhit, gjykata e apelit duhet të lejojë palët, veçanërisht palën e tretë Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, që të paraqesë provat përkatëse në mbështetje të argumenteve dhe prapësimeve lidhur me gjendjen e ortakërisë së shoqërisë "*Pranvera*" *sh.p.k.* dhe faktin nëse është ose jo në likuidim.

45. Duke pasur parasysh interpretimin e njehsuar të ligjit të parashtruar më sipër në këtë vendim unifikues, për sa u përket kufijve dhe objektit të gjykimit të posaçëm të njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, nëse nga vetë palët do të paraqiten prova, të cilat i nënshtrohen debatit në gjykim, atëherë gjykata e apelit duhet të arsyetojë në mënyrë të qartë dhe ezauruese, lidhur me rrethanat e faktit që do të pranohen të vërtetuara prej saj, si edhe për ekzistencën ose jo të ndonjë ndalese a pengese konkrete ligjore nga ato të treguara në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 5 të Konventës së Nju-Jorkut, duke konkluduar e disponuar për pranimin apo rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të datës 22.12.2005 të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit (I.C.C.) të dhënë nga arbitri i vetëm me qendër në Gjenevë, prof. dr. Claudie B. Rouillier, që i përket çështjes nr. 12112/ACS.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 1 të nenit 141 të Kushtetutës, të neneve 481 e 485 të Kodit të Procedurës Civile dhe të nenit 17 të ligjit nr. 8588, datë 15.3.2000 "*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë",*

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr. 82, datë 7.9.2007 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim po asaj gjykate, me tjetër trup gjykues.

2. Ky vendim është unifikues dhe dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Shpresa Beçaj (kryesuese), Gani Dizdari, Ardian Dvorani, Ardian Nuni, Fatos Lulo, Besnik Imeraj, Aleksandër Muskaj, Arjana Fullani, Majlinda Andrea, Evelina Qirjako, Andi Çeliku, Guxim Zenelaj, Medi Bici, Mirela Fana